



Planimar / Dëftesa Puniljenor/Prudato Reshvat/Delivry	29.03.2022	2	viti god year
Organ / Injesta Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMB/HOK	1682/2022		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.180/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.144/2020 të datës 21.02.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.751/2019 të datës 05.12.2019 të parashtruar nga ankuesja

në Komunën e Istogut, kundër Vendimit 02 Nr.259/19 të datës 11.11.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Istogut, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 29.03.2022, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.751/2019 e datës 05.12.2019 e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi 02 Nr.259/19 i datës 11.11.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Istogut.

A r s y e t i m

Ankuesja kandidate për shërbim civil me datë 05.12.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit 02 Nr. 259/19 të datës 11.11.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Istogut, me pretendimet ankimore së vendimi i kundërshtuar është i përfshirë më shkelje procedural, konstatim të gabuar të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.12.2019, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Istogut. Ndërsa kjo e fundit më datë 19.12.2019 ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me dokumentacionin e kërkuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 09.01.2020 përmes shkresës zyrtare me numër protokollit 3865 ka njoftuar anësuesen lidhur me pamundësinë e shqyrtimit të ankesës A.nr.751/2020, për shkak të mungesës së kuorumit për vendosje, duke udhëzuar të njëjtën që të inicioj konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 21.02.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.144/2020 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 09.01.2020 dhe ka detyruar të njëjtin që brenda tridhjetë (30) ditësh të vendos për ankesën e ankueses të datës 05.12.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 5685/2019 të datës 05.12.2019 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 10.12.2019; Përgjigjen në ankesë e datës 19.12.2019; Ankesën e ankueses e parashtruar në Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Istogut më datë 29.10.2019; Vendimin me numër 02Nr. 259/19 të datës 11.11.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Istogut; Procesverbal i datës 11.11.2019 i Komisionit të Ankesave; Kërkesën për fillimin e rekrutimit e datës 16.08.2019; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 16.08.2019; Autorizimi i DASHC/MAP i datës 27.08.2019; Konkursin e datës 02.09.2019 për pozitën "Sekretar i Shkollës Filllore të Mesme të Ulët Trepça" të shpallur nga Komuna e Istogut; Njoftimin e datës 17.09.2019; Regjistrin e kërkesave të pranuar; Deklaratë e datës 26.09.2019; Vendimin me Nr. 01-638/019 i datës 27.09.2019 për formimin e komisionit për intervistim të kandidatëve; Form.MAP-SHCK-05 për përcaktimin e kriterëve për përfshirjen në listën e ngushtë; Lista e ngushtë e kandidatëve e datës 03.10.2019; Form.MAP-SHCK-07a për përcaktimin e kriterëve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Njoftimi i kandidatëve të listës së ngushtë për mbajtjen e testit me shkrim dhe me gojë përmes thirrjes telefonike i datës 08.10.2019; Form.MAP-SHCK-09 për përmbledhjen e vlerësimeve individuale; Form.MAP-SHCK-10 për renditjen përfundimtare të kandidatëve; Form.MAP-SHCK-11 i raportit final i rekomandimi nga komisioni rekrutues datë 23.10.2019; Vendim i datës 24.10.2019; Njoftim i datës 24.10.2019; Form.MAP-SHCK-08a për vlerësimin individual të kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhë të huaj për ankuesen dhe kandidaten

Testin me shkrim i datës 10.10.2019 i kandidatës dhe ankueses; Kërkesën për punësim e kandidatës dhe ankueses së bashku me dëshmitë e përgatitjes profesionale dhe përvojës së punës; Njoftimin e datës 09.01.2020 për ankuesen dhe Aktgjykimin A.nr.144/2020 të datës 21.02.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankueses, *është e pabazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se Komuna e Istogut në bazë të autorizimit të datës 27.08.2019 të Departamentit të Administrimit të Shërimit Civil/Ministrisë së Administratës Publike, me datë 02.09.2019 ka shpallur konkursin me numër reference RN00005501, për pozitën *Sekretar i Shkollës Filllore të Mesme të Ullët Trepça* në fshatin Banjë, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja. E njëjta është ftuar të marrë pjesë në të gjitha fazat e procedurës së rekrutimit respektivisht në testin me shkrim dhe intervistën me gojë.

Bazuar në propozimin e Komisionit Përzgjedhës të datës 23.10.2019, Komuna e Istogut më datë 24.10.2019 përmes Vendimit nr.01-715/2019 ka publikuar njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit të suksesshëm për pozitën *Sekretar i Shkollës Filllore të Mesme të Ullët Trepça*, respektivisht kandidatja është shpallur si kandidatja me e suksesshme me gjithsej 90.8% pikë.

Ankuesja, e pakënaqur me mos përzgjedhjen për pozitën në fjalë, me datë 29.10.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Istogut, ndërsa ky i fundit me Vendim me numër 02Nr. 259/19 të datës 11.11.2019 ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses, duke lënë në fuqi njoftimin për kandidatin e suksesshme të datës 24.10.2019.

Ankuesja kundër Vendimit 02 Nr. 259/19 të datës 11.11.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Istogut, më datë 05.12.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 5685/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se vendimi i kundërshtuar është i përfshirë më shkelje procedural, konstatim të gabuar të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Me tej shton së kandidatja e përzgjedhur nuk ka plotësuar kushtet e parapara me konkurs sepse e njëjta nuk ka përvojë profesionale respektivisht nuk ka përvojë në fushën e arsimit ashtu siç është kërkuar me konkurs.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses se kandidatja e përzgjedhur nuk ka plotësuar kushtet e parapara me konkurs sepse njëjta nuk ka përvojë profesionale respektivisht nuk ka përvojë në fushën e arsimit, Kolegji sipas Autorizimit të DASHC-së të ditës 27.08.2019 për publikimin e konkursit për pozitën *Sekretar i Shkollës Filllore Kod AR/680* ka gjetur së për pozitën në fjalë si kritere bazë të përcaktuar kanë qenë: *Diploma universitare, Fakulteti Juridik, Ekonomik dhe Administratë Publik, Minimum 2 vite përvojë pune profesionale, njohuri për fushën profesionale specifike të arsimit të fituar universitar dhe trajnime përkatëse, dhe rrjedhimisht nga dokumentacioni i aplikimit të kandidatës së përzgjedhur, Kolegji ka konstatuar së e njëjta sipas Certifikatës ref.nr. K-12/08-05/635 të datës 22.01.2013, të lëshuar nga Fakulteti Juridik i Universitet të Prishtinës, ka përfunduar studimet me datë 08.10.2012 dhe ka marr titullin Jurist i diplomuar-Bachelor, kurse sipas Certifikatës me ref.nr.03-19/77 të datës 16.04.2019 ka të përfunduar Mastar në të Drejtën Kushtetuese dhe Administrative Fakulteti Juridik në Prishtinë. Përkitazi me përvojën e punës Kolegji bazuar në Kontratën e Punës të datës 01.08.2017 dhe Pasqyrën e Trustit Pensional ka gjetur së kandidatja e përzgjedhur ka përvojë të punës pas diplomimit respektivisht nga muaji korrik 2017 deri korrik 2019, dhe si rrjedhojë e njëjta ka plotësuar kushtin e përvojës së punës profesionale pas*



diplomimit, e mbi këtë bazë rrjedhë se nuk qëndron pretendimi ankimor se ankuesja nuk ka përvojë në fushën e arsimit ngase sipas Autorizimit të DASHC-së të datës 27.08.2019 për pozitën e Punës Sekretare e Shkollës Fillore kërkohet njohuri nga fusha e arsimit universitar të përfunduar (*Fakultetit Juridik, Ekonomik apo Administrata Publike*).

Po ashtu, Kolegji nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka gjetur se edhe ankuesja ka plotësuar kushtet e arsimit dhe përvojës së punës, dhe se mbi këtë bazë Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil në mënyrë të drejtë ka vlerësuar aplikacionet e ankueses dhe kandidates se përzgjedhur duke vepruar në pajtim me nenin 28 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kritereve si në vijim: 1.1arsimimi dhe kualifikimi profesional, përvoja e punës, shkathësia dhe aftësitë dhe elementet e tjera të meritë*. Mirëpo Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në bazë vlerësimit përfundimtar të Komisionit përzgjedhës ka gjetur së kandidatja e përzgjedhur është vlerësuar si kandidatja me më shumë pikë gjithsej me 90.8% të pikëve, ndërsa ankuesja është vlerësuar si kandidatja e dytë me gjithsej 71.8% të pikëve, dhe si rrjedhojë Kolegji vlerëson se Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtim me nenin 40 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ku parashihet se: *Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë*".

Kolegji pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe bazuar në konstatimet si me lart, vlerëson se procedura e rekrutimit për pozitën e punës Sekretar i Shkollës Fillore të Mesme të Ulët Trepça në fshatin Banjë është zhvilluar në pajtim me nenin 11 paragrafin 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: *Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve*.

Andaj, nisur nga gjendja faktike dhe baza juridike e konstatuar si me lart, rezulton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Istogut me rastin e nxjerrjes së Vendimit 02 Nr.259/19 të datës 11.11.2019, ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nenparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.180/2022

Ilire Mehmeti Shaqiri

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Kryetarit të Komunë së Istogut;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Istogut dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së